



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 238, Datë 26.11.2021

MBI

FILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “ALBANIAN
ENERGY SUPPLIER 2” SH.P.K., NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, gërma “d”, të ligjit nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” i ndryshuar, nenit 4, pika 1, gërma “e”, nenit 5, pika 1, gërma “e”, nenit 10, pika 3, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s, nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar, si dhe nenit 19, pika 1, gërma “a”, të “Rregullores për Organizimin, Funkcionimin dhe Procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 26.11.2021, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 144/2 prot., datë 16.11.2021, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikqyrjes, “Mbi aplikimin e shoqërisë “Albanian Energy Supplier 2” sh.p.k., për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”,

Konstatohet se:

- Shoqëria “Albanian Energy Supplier 2” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1074 prot., datë 11.11.2021, ka paraqitur aplikimin për t’u pajisur me licencë në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.
- Shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit për tu pajisur me licencë në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, nga ERE, në zbatim të Aneksit A, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”.
- Nga analiza e dokumentacionit në fazën e fillimit të procedurave të licencimit në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, për shoqërinë “Albanian Energy Supplier 2” sh.p.k., rezulton se subjekti plotëson kryesisht kërkesat e “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, si më poshtë:
 - Formati dhe dokumentacioni për aplikim, neni 9, pika 1, gërmat “a”, “b”, **plotësuar.**
 - Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor, neni 9, pika 3, gërmat “a”, “b”, “c”, “e”, **plotësuar.**

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal, neni 9, pika 3, gërma “a”, “c”. “d”, **plotësuar.**
 - Dokumentacioni teknik për veprimtarinë tregtimit të energjise elektrike, neni 9, pika “a”, “c”, **plotësuar.**
- Në lidhje me mungesën e dokumentacionit, që ka të bëjë me:
 - Formati dhe dokumentacioni për aplikim, neni 9, pika 1, gërma “c” (të dhëna për aplikuesin);
 - Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor, neni 9, pika 2, gërma “d” (vertetimi nga Prokuroria dhe Gjykata);
 - Dokumentacioni financiar dhe fiskal, neni 9, pika 3, gërma “b” (bilanci financiar të tre viteve të fundit / ose të kohës së ekzistencës së shoqërisë (për shoqëritë me ortakë shoqëri të tjera paraqitja e bilancit të këtyre të fundit).
 - Dokumentacioni teknik për veprimtarinë tregtimit të energjise elektrike, neni 9, pika 4.8, gërma “b” (Kapitali financiar (i shprehur në vlera monetare) i parashikuar për ushtrimin e kësaj veprimtarie, i shoqëruar me vërtetim nga banka apo institucione të tjera financiare të njohura me ligj), do të njoftohet subjekti që në bazë të neneve 10, pika 10 dhe 11, të “*Rregullores për Procedurat dhe Afatet për Dhënie, Modifikimin, Transferimin, Rinovimin ose Heqjen e Licencave në Sektorin e Energjisë Elektrike*”, t’i paraqesë ato brenda afateve.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Albanian Energy Supplier 2” sh.p.k, në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 5 vjeçar.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit AHMETI